



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 1370 / prot.

Tiranë, më 10/3 /2020

URDHËR

Nr. 156 /, datë 10.03 .2020

PËR

NDALIMIN E TË GJITHA LËVIZJEVE SË UDHËTARËVE DREJT ITALISË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 7, pika 3, gërmat "a" të Ligjit Nr.15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", si edhe në përputhje me Rregulloren Ndërkombëtare të Shëndetit, Vendimin e Komitetit të përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e lëvizjeve të udhëtarëve me mjetet e transportit ajror nga Aeroporti "Nënë Tereza, Tiranë drejt Italisë, deri në një Urdhër të dytë.
2. Ndalimin e lëvizjeve me mjetet e transportit detar nga të gjithë portet në vend drejt Italisë, deri në një Urdhër të dytë.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Inspektorati Shtetëror Shëndetësor dhe Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor të bashkëpunojnë me Autoritetin Portual Durrës, Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe Tirana International Aeroport.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI
Ogerta Manastirliu